



## **RAPORT HULUMTIMI**

*(version i shkurtuar)*

### **Bullizmi, motivimi, leximi dhe interneti në shkolla**

Prishtinë, prill 2020

**Autor i hulumtimit:** Muhamet KRASNIQI, Sociolog,  
profesor në Gjinnazin “Eqrem Çabej”, Prishtinë

**Anketues/e:** Blearta Ukëhaxhaj (koordinatore e grupit), Blend Bunjaku, Venera Kameri,  
Sonila Pacolli, Marigona Beqiri, Agnesa Brajshori, Yllka Duriqi, Verona Halimi dhe Diellza  
Ibrahimi.

---

Prishtinë, 2020

## **Përmbajtja:**

I.	Hyrje .....	4
II.	Qëllimi i hulumtimit .....	6
III.	Hipoteza .....	6
IV.	Metodologjia .....	6
V.	Analiza e rezultateve .....	7
VI.	Përfundim .....	17
VII.	Rekomandime .....	18

## I. Hyrje

Duke qenë se shekulli XXI është duke u karakterizuar me intensifikim të sfidave, ndryshimeve, zhvillimeve dhe probleme shumëdimensionale, nga ato politike, ekonomike, kulturore, arsimore, mediatike, teknologjike, shoqërore, psikologjike, shëndetësore dhe ato të mjedisit, sfida këto të cilat ndikojnë me theks të veçantë tek adoleshentët, është parë e nevojshme të realizohet një hulumtim që do t'i maste opinionet e adoleshentëve për bullizmin, leximin, internetin, motivin dhe demotivimin në raport me shkollën dhe për të kuptuar kështu se cili ka qenë ndikimi i disa prej këtyre zhvillimeve në jetën e tyre.

Ky hulumtim me temën “Bullizmi, motivimi, leximi dhe interneti në shkolla” ka për qëllim të identifikojë se cila është gjendja faktike, prioritetet, qëndrimet, sfidat dhe motivet e nxënësve në raport me bullizmin (ngacmimin), leximin, dukuritë negative, internetin, këshillat për bashkëmoshatarët dhe studimet universitare. Nëpërmjet identifikimit të këtyre indikatorëve do të adresohen përgjegjësitë tek institucionet përkatëse, shkollat, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe mediat, se cilët duhet të jenë hapat që duhet të ndërmerren për ta përmirësuar gjendjen në arsimin parauniversitar, e cila do të manifestohej me ngritjen e cilësisë në mësimnxënie, mirësjellje, tolerancë, respekt të ndërsjellë dhe largim nga dukuritë negative.

Vlen të theksohet se pavarësisht se janë krijuar disa perceptime tek të rriturit se adoleshentët nuk i kushtojnë rëndësi familjes, ata megjithatë e rendisin atë si prioritetin më të lartë në jetën e tyre.

Sa i përket bullizmit dhe dhunës në shkolla, nxënësit mendojnë se dhuna verbale dhe psikologjike është më e shprehur në shkolla, ndërkohë që nevojën për të treguar superioritet, e rendisin si arsye kryesore përse ngacmojnë bullistët.

Përgjegjësitë kryesore për parandalimin e bullizmit ia adresojnë prindërve, nxënësve, drejtorisë së shkollës, policisë, mësimdhënësve, MASHT-it, komunitetit, DKA-së dhe mediave. Ndërkohë që si masa kryesore që duhet të ndërmerren për parandalimin e dhunës në shkolla i deklarojnë: edukimin familjar (32%), angazhimin e psikologëve në shkolla (29%), përdorimin e masave disiplinore (16%), trajnimet në shkolla për parandalimin e dukurive negative (7%) etj.

Sa i përket arsyeve pse ka rënë motivi për lexim dhe mësim, nxënësit kanë identifikuar dhënien pas teknologjisë (30%), tekstet e vjetra dhe joatraktive (shkollore) me 30%, si dy shkaktarët kryesorë.

Lidhur me përdorimin e telefonave mobilë gjatë orës së mësim, vetëm 9% e të anketuarve janë shprehur se asnjëherë nuk e përdorin telefonin mobil gjatë orëve mësimore, ndërsa 23% rrallë, 42% ndonjëherë dhe 26% shumë. Ndërkaq, sa i përket qëndrimit në internet gjatë ditës, 50% e tyre vlerësojnë se qëndrojnë mbi 5 orë në ditë, 41% mbi 3 orë dhe 9% deri 1 orë në ditë.

Ndërkohë që, lidhur me pyetjen sa lexojnë gjatë ditës, 13% e nxënësve janë shprehur se lexojnë deri 10 minuta, 18% deri 40 minuta, 23% deri 1 orë, 18% deri 2 orë, 9% deri 4 orë,

ndërsa 19% shprehen se nuk lexojnë aspak. Librat shkollorë, romanet dhe librat psikologjikë janë librat më të preferuar për nxënësit.

Sa i përket këshillave për bashkëmoshatarët e tyre, ata si më të rëndësishme deklarohen: të jenë të sjellshëm dhe të edukuar, t'i përkushtohen familjes, të mësojnë më tepër etj.

## II. Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim të identifikojë se cila është gjendja faktike, prioritetet, qëndrimet, sfidat dhe motivet e nxënësve në raport me bullizmin, leximin, motivimin dhe demotivimin në raport me shkollën, substancat narkotike, internetin dhe planifikimet për studime universitare. Nëpërmjet identifikimit të këtyre indikatorëve do të adresohen përgjegjësitë tek institucionet përkatëse, shkollat, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit dhe mediat, se cilët duhet të jenë hapat që duhet të ndërmerren për ta përmirësuar gjendjen në arsimin parauniversitar, e cila do të manifestohej me ngritjen e cilësisë në mësimnxënie, mirësjellje, tolerancë, respekt të ndërsjellë dhe largim nga dukuritë negative.

## III. Hipoteza

Hipoteza që e kemi shtruar për këtë hulumtim lidhet me faktin se bullizmi është bërë një fenomen shqetësues në shkollat e mesme, i cili më tepër ka dimension psikologjik, por nuk mungojnë as format tjera, ndërkohë që varësia nga teknologjia dhe perceptimi për mungesën e perspektivës e ka ulur motivimin e nxënësve për mësim. Gjithashtu edhe mungesa e disiplinës dhe konsumimi i duhanit janë bërë trend në rritje, ndërkaq përdorimi i marihuanës, ndonëse ende në numër të vogël, është bërë shqetësim i madh.

## IV. Metodologjia

Hulumtimi është realizuar përmes metodës kuantitative dhe është aplikuar me anë të pyetësorëve anonim në gjashtë shkolla të mesme të Prishtinës: “Eqrem Çabej“, “Sami Frashëri“, “Xhevdet Doda“, “Hoxhë Kadri Prishtina“, “Gjin Gazulli“ dhe “28 Nëntori”.

Nga 3.077 nxënës të klasave XII në Komunën e Prishtinës, të vitit shkollor 2019/2020, janë anketuar 977 nxënës nga të dy gjinitë<sup>1</sup>, të shpërndarë në 69 paralele, me margjinë të gabimit 2.59.

Anketimi është realizuar nga nëntë nxënës të klasave XII nga Gjimnazi “Eqrem Çabej” në Prishtinë, nga data 2 – 9 mars 2020, nën udhëheqjen e profesorit të Sociologjisë Muhamet Krasniqi.

**Anketuesit janë ndarë në tre grupe:**

**Grupi I.** Blearta Ukëhaxhaj (XII 3), Blend Bunjaku (XII 2), Venera Kameri (XII 1)

**Grupi II.** Sonila Pacolli & Marigona Beqiri (XII 5), Agnesa Brajshori (XII 4)

**Grupi III.** Yllka Duriqi & Verona Halimi (XII 6) dhe Diellza Ibrahim (XII 7)


---

<sup>1</sup> Për faktin se një pjesë e nxënësve nuk e kanë rrethuar asnjërin gjini, nuk mund ta dimë me saktësi sa ka qenë raporti në mes vajzave dhe djemve të anketuar, shumica e të cilëve i përkasin moshës 17 dhe 18 vjeç.

## V. Analiza e rezultateve


### 2. Çfarë nënkuptoni më tepër me sjellje të dhunshme të një nxënësi? (Rretho DY opsione)?

Në këtë pyetje dhunën fizike dhe fyerjet e sharjet i kanë vlerësuar me 32%, ndërsa presionin psikologjik me 24%. Nga kjo vërehet se dhuna verbale është më e shprehur kur i bashkojmë dy opsionet.




### 5. Për çfarë arsye ngacmojnë më tepër bullistët:

‘Nevoja për të treguar superioritet (epërsi)’ është vlerësuar nga 49% e të anketuarve si arsyeja më e rëndësishme përse ngacmojnë bullistët, ‘të pakënaqur me veten’ e kanë parë si arsyen e dytë me 34%.




### 7. A ka dhunë në shkollën tuaj?

Sa i përket dhunës në shkollë, vetëm 12% e nxënësve shprehen se aspak nuk është e pranishme, shumë pak 18%, pak 43% dhe shumë 17%.



### 8. Cila prej llojeve të dhunës është më e shprehur në shkollën tuaj?


Sa i përket llojeve të dhunës, 62% e nxënësve vlerësojnë se ajo është e shprehur se ajo ka dimension psikologjik/emocional, ndërsa 34% mendojnë se ka dimension fizik.






**11. Kujt ia adresoni përgjegjësitë kryesore për parandalimin e bullizmit (ngacmimit)? (Vlerësoje secilin prej opsioneve: përgjegjësia më e lartë = 5, përgjegjësia më e ulët = 1)**

Në këtë grafikon pasqyrohet me shifra reale (jo me përqindje) se kë e shohin nxënësit përgjegjës për parandalimin e bullizmit. Siç vërehet **përgjegjësia më e lartë (vlerësimi 5)** ia dedikojnë në masën më të madhe prindërve (358), pastaj vetë nxënësve (345), më pas drejtorisë së shkollës (293), policisë (280) dhe kështu me radhë siç pasqyrohet në grafikon.



**12. Cilat janë masat që duhet të ndërmerren për ta parandaluar dhunën në shkollë? (Rretho DY opsione më të rëndësishme).**


Sa i përket masave të cilat duhet të ndërmerren për parandalimin e dhunës në shkollë, 32% e nxënësve të anketuar vlerësojnë se edukimi familjar duhet të jetë primar, 29% vlerësojnë angazhimin e psikologëve në shkollë dhe 16% mendojnë se duhet të përdoren masat disiplinore.



**13. Për cilat arsye mendoni se ka rënë motivi për lexim dhe mësim? (Rretho DY opsionet kryesore).**


Sa i përket rënies së motivit për lexim, dy arsyt kryesore me vlerësimin prej 30% i rendisin: dhënien pas teknologjisë dhe tekstet e vjetra dhe jo atraktive (shkolllore).

*Kujtojmë se për klasët 12 ende nuk kanë dal botimet e reja të librave në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës.*




**18. A keni konsumuar ndonjëherë substanca narkotike?**

Në pyetjen e drejtpërdrejtë, nëse kanë konsumuar ndonjëherë substanca narkotike, 68% e të anketuarve janë përgjigjur se asnjëherë nuk kanë konsumuar, 7% janë përgjigjur po një herë, 13% kanë refuzuar të përgjigjen, dhe vetëm 12% janë përgjigjur po, disa herë.




### 19. A jeni konsumues i duhanit?

Në pyetjen për konsumimin e duhanit, me vetëm dy opsione 70% e të anketuarve shprehen se nuk konsumojnë, dhe 30 janë përgjigjur pozitivisht.




### 21. A e përdorni telefonin mobil gjatë orës së mësimt?

Në këtë pyetje, siç na paraqet grafikoni, vërehet se nxënësit e përdorin telefonin mobil gjatë orës së mësimt. 29% shumë, 42% nganjëherë, 23% rrallë dhe vetëm 9% e nxënësve asnjëherë nuk e përdorin telefonin mobil gjatë orës së mësimt.




## 22. Mesatarisht sa orë qëndroni në internet gjatë ditës?

Lidhur me qëndrimin në internet gjatë ditës, vërehet se nxënësit qëndrojnë jashtëzakonisht shumë në internet. 50% e tyre shprehen se qëndrojnë mbi 5 orë në ditë, 41% deri 3 orë, dhe vetëm 9% deri 1 orë.




## 23. Për çfarë arsye e përdorni internetin më tepër? (Rretho TRE opsionet kryesore).

Tre arsyet për çfarë nxënësit e përdorin internetin janë: biseda me bashkëmoshatarë (25%), dëgjimi i muzikës (21%) dhe për informacione ditore (16%)




## 24. Mesatarisht sa orë lexoni gjatë ditës?

Në pyetjen rreth leximit gjatë ditës, vetëm 9% lexojnë deri në 4 orë në ditë, 18% deri në 2 orë, dhe 19% shprehen se nuk lexojnë aspak.




## 25. Çfarë lloje të librave lexoni më tepër?

Librat që nxënësit lexojnë më tepër janë librat shkollorë (28%), librat psikologjik (18%) dhe romanet (20%). Ndërkohë që 15% e të anketuarve nuk lexojnë asnjë lloj librash.




## 26. Çfarë ju motivon të vini në shkollë?

Sa i përket motivimit të shkojnë në shkollë, ajo që nxënësit i motivon më tepër është shoqëria (36%), perspektiva për të ardhmen (31%), përvetësimi i diturisë (11%), ndërkohë që 16% e tyre nuk kanë nguruar të theksojnë se është “thjeshtë diploma” ajo që i motivon të shkojnë në shkollë.




## 27. Çfarë ju demotivon të vini në shkollë? (Rretho DY opsione).

Ajo çfarë nxënësit i demotivon më tepër të shkojnë në shkollë janë: detyrat e shumta 26%, tekstet e vjetra (shkollore) 21% dhe mungesa e perspektivës 17%.




### 30. Rendisni prioritet në jetën tuaj? (5= prioriteti më i lartë, 1 prioriteti më i ulët).

Pavarësisht faktit se prindërit mund të kenë krijuar përshtypje se fëmijët nuk e vlerësojnë familjen, 695 nxënës të anketuar e kanë renditur familjen me prioriteti më të lartë 5. Ndërsa vetëm 106 nxënës i kanë parë mediat me prioritet më të lartë.




### 31. Çfarë i këshilloni bashkëmoshatarët tuaj? (rrethoni TRE këshillat më të rëndësishme).

Sa i përket këshillave që nxënësit kanë për bashkëmoshatarët e tyre, vërejmë qartë se ata e vlerësojnë shumë **edukatën, familjen, dhe mësimin**, me ç'rast këto tre opsione kanë përqindjen më të lartë.



### 32. Në çfarë drejtimi planifikoni t'i vazhdoni studimet?

Fakulteti i Mjekësisë, Inxhinierisë elektronike-kompjuterike, i shkencave shoqërore dhe shkencave matematikore janë, fakultetet më të preferuara për nxënësit e anketuar. Por tek opsioni **Tjetër** (22%) janë përfshirë drejtimit: *Ekonomik, Juridik, Akademia e Arteve, Arkitekturë, Psikologji, Kriminalistikë, Edukimi Fizik dhe i Sportit, Këndim dhe shprehja "të pavendosur"*.





## **VI. Përfundim**

*Në bazë të rezultateve të hulumtimit kemi ardhur në këto përfundime:*

Nga të dhënat e mësipërme nevoja për të treguar epërsi është vlerësuar si arsyeja kryesore pse ngacmojnë bullistët (ngacmuesit).

Sa i përket dhunës në shkolla, rezulton se ajo është pak e shprehur dhe se ka më tepër karakter psikologjik dhe verbal. Ndërkohë që përgjegjësitë më të mëdha për parandalimin e bullizmit nxënësit ia dedikojnë prindërve, vet nxënësve dhe drejtorive të shkollës.

Tekstet e vjetra dhe joatraktive (shkollore) dhe dhënien pas teknologjisë, nxënësit e anketuar i kanë vlerësuar si dy arsyt kryesore pse ka rënë motivi për lexim.

Lidhur me qëndrimin në internet gjatë ditës dhe leximit ka një diferencë të theksuar në favor të internetit, me ç'rast 50% e respondentëve shprehen se qëndrojnë në internet mbi pesë orë në ditë, ndërsa vetëm 9% lexojnë deri në katër orë në ditë.

Shoqëria dhe perspektiva për të ardhmen janë dy faktorët kryesorë që i motivojnë nxënësit e anketuar të shkojnë në shkollë. Në anën tjetër, detyrat e shumta, tekstet e vjetra (shkollore), mungesa e perspektivës dhe rruga e gjatë janë vlerësuar ndër arsyt kryesore që i demotivojnë përgjatë procesit mësimorë. Nëse i krahasojmë motivin dhe demotivimin në raport me shkollën, atëherë perspektiva për të ardhmen me 31% dominon ndaj mungesës së perspektivës me (17%).

Ndonëse vërehet qartë se nxënësit kanë një lidhje të pashkëputshme me teknologjinë, kjo nuk ka ndikuar aspak në zbehjen e vlerësimit për rëndësinë e familjes.

Të jenë të sjellshëm dhe të edukuar, të mësojnë më tepër dhe t'i përkushtohen familjes, janë tre sugjerimet kryesore me të cilat nxënësit i këshillojnë bashkëmoshatarët e tyre.

Sa i përket planifikimit për studime, nxënësit kanë preferenca të ndryshme, dhe nuk vërehet se ka një dallim të madh ndërmjet fakulteteve që preferojnë ata.

## **VII. Rekomandime**

### **NXËNËSIT**

- Të jenë më të përkushtuar përgjatë procesit mësimorë, të manifestojnë shprehje, sjellje korrekte, të drejta e pozitive me bashkëmoshatarët e tyre dhe komunitetin në përgjithësi; t'i shfrytëzojnë anët e dobishme të internetit dhe ta kufizojnë përdorimin e tij, duke e kompensuar me lexim dhe aktivitete rekreative e sportive; të kujdesen që me fjalët dhe sjelljet e tyre mos të cenojnë integritetin psikik, moral, fizik dhe ekonomik të askujt, e veçanërisht bashkëmoshatarëve të tyre;
- Nxënësit që ushtrojnë bullizëm të vetëdijesohen se nuk mund ta ngritin vetveten duke nënçmuar të tjerët;
- Ata nxënës që janë përfshirë në dukuri të ndryshme negative duhet ta kuptojnë se asnjëherë nuk është vonë të largohen prej tyre, por që gjithashtu duhet të ndërjegjësohen se sa më tepër të shoqërohen prej tyre, aq më vështirë do ta kenë t'i shmangen atyre;
- T'i raportojnë rastet e bullizmit dhe dhunës tek prindërit, mësimdhënësit, kujdestarët, drejtorja e shkollës, DKA dhe organe tjera kompetente;
- Të përmbahen nga paragjykimet, gjykimet e njëanshme, të ngutshme dhe impulsive;
- Edukata, mirësjellja, dialogu, respekti, butësia dhe kërkim falja të shihen si virtyte që duhen përqaftuar dhe asnjëherë si tipare që të bëjnë 'frikacak', e prej të cilave duhet larguar.

### **PRINDËRIT**

- Të përcjellin vazhdimisht progresin e fëmijëve të tyre, t'i këshillojnë për edukatën, tolerancën, mirësjelljen, respektin;
- T'u bëjnë të ditur fëmijëve të tyre se pritshmëritë për ata i kanë të mëdha, andaj përmbushja e tyre është e kushtëzuar nga angazhimi i vazhdueshëm.

### **INSTITUCIONET ARSIMORE**

- MASHT dhe DKA të zbatojnë politika arsimore të cilat nxënësve do t'ua bëjnë të dashur shkollimin. Të ofrojnë kushte për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës dhe tekste në përputhshmëri me këtë dokument arsimor;
- Të pajisin shkollat me libra të fushave të ndryshme dhe të krijohen hapësira për leximin e tyre në biblioteka të shkollës;
- Drejtoritë e shkollave të respektojnë Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Udhëzimet Administrative rreth arsimit parauniversitar dhe të krijojnë klimë gjithëpërfshirëse në shkolla;
- Shkollat të ndajnë mirënjohje edhe për nxënësit e sjellshëm, të edukuar dhe respektues të rregullores, në mënyrë që këto cilësi të promovohen si vlera që duhet ndjekur nga të tjerët.